



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
MBLEDHJA E GJYQTARËVE

V E N D I M

Për kërkesën për pezullim

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Marsida Xhaferllari,	Kryesuese
Fiona Papajorgji,	Anëtare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Sandër Beci,	Anëtar
Genti Ibrahimimi,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare
Ilir Toska,	Anëtar

në datën 30.10.2024 mori në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga kërkuesi Igor Kokunov për pezullimin e procedurave për ekstradimin e tij në Federatën Ruse.

V Ë R E N:

1. Kërkuesi Igor Kokunov rezulton të jetë person i shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpol NCB Moska, referuar vendimit penal administrativ dhënë nga gjykata e Moskës, i datës 18.02.2022, e cila ka caktuar ndaj tij masën e sigurimit “Arresti në burg”, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Marrja e një pozicioni më të lartë në hierarkinë penale”, të parashikuar nga neni 201/a i Kodit Penal (KP) të Federatës Ruse.

2. Kërkuesi është arrestuar në datën 27.08.2023, nga Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër dhe me vendimin e datës 578, datë 14.11.2023, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ka vendosur ekstradimin e tij në Federatën Ruse. Ky vendim është lënë



në fuqi nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me vendimin nr. 591, datë 20.02.2024.

3. Mbi rekursin e kërkuarit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2024-1533, datë 24.09.2024 ka vendosur lënien në fuqi të vendimeve për ekstradimin e kërkuarit.

4. Kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për pezullimin e vendimeve që kanë vendosur ekstradimin e tij, bazuar në nenin 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, duke parashtruar si shkak se trajtimet çnjerëzore dhe degraduese në institucionet penitenciare ruse ndaj të burgosurve dhe të paraburgosurve janë tashmë të raportuara dhe të verifikuara nga organizatat ndërkombëtare. Sipas tij, Rusia ka denoncuar KEDNJ-në dhe nuk është më pjesë e Këshillit të Evropës dhe se me njoftimin e datës 03.02.2023 vetë GJEDNJ-ja ka komunikuar se ky shtet nuk është palë e KEDNJ-së. Për rrjedhojë, sipas kërkuarit, ai do të përballet me ndëshkime të padrejta, torturë ose trajtim çnjerëzor në përputhje me praktikat që janë të zakonshme në Rusi.

5. Sipas nenit 45, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, të ndryshuar, Gjykata, kryesisht ose me kërkesë të palëve, kur vlerëson se zbatimi i ligjit ose aktit mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërore, shoqërore ose të individëve, sipas rastit, me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve ose në seancë plenare urdhëron pezullimin e tij.

6. Mbledhja e Gjyqtarëve, pasi mori në shqyrtim kërkesën për pezullim vlerëson se ajo është e bazuar dhe duhet të pranohet. Në vlerësimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve në rastin konkret janë të pranishme kushtet e urgjencës për marrjen e kësaj mase, pasi nga informacionet e marra nga institucionet kompetente, ministri i Drejtësisë, në zbatim të vendimeve gjyqësore që kanë lejuar ekstradimin e kërkuarit, me urdhrin e datës 14.10.2024 ka miratuar ekstradimin nga Shqipëria në Federatën Ruse të shtetasit rus Igor Kokunov, ekstradim që do të kryhet ditën e sotme, datë 30.10.2024, ora 18:20. Po kështu, në vlerësimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve shkaqet e parashtruara nga kërkuari kanë të bëjnë me pretendime me natyrë kushtetuese për sa kohë lidhen me të drejtat themelore të individit, ndaj rrëzimi i kësaj kërkesë do e bënte jo efektiv dhe iluzor vetë shqyrtimin e ankimit kushtetues individual. Nga ana tjetër, rezulton se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk është i publikuar ende në faqen zyrtare të saj dhe kërkuari pretendon se ky vendim nuk është arsyetuar ende, për rrjedhojë ai nuk është njohur ende me shkaqet për të cilat ajo gjykatë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit për ekstradim. Mbledhja e Gjyqtarëve merr në konsideratë edhe faktin se Federata Ruse nuk është më pjesë e Këshillit të Evropës, ndërkohë që pretendimet e tij lidhen edhe me mbrojtjen e të drejtave konventore, si edhe faktin se në vitin 2022 GJEDNJ-



ja ka konstatuar shkelje të neneve 3 dhe 5 të KEDNJ-së në ndjekjen penale të kërkuesit.

7. Për sa më sipër, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se janë kushtet që imponojnë pezullimin e përkohshëm të kësaj procedure, deri në një vendimmarrje të dytë të Gjykatës Kushtetuese, kohë gjatë të cilës kërkuesi vijon të qëndrojë në kushtet e izolimit në pritje të ekstradimit të tij.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 45, pika 1, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 27 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës,

V E N D O S I:

- Pezullimin e përkohshëm të procedurave të ekstradimit të shtetasit rus Igor Kokunov deri në një vendimmarrje të dytë të Gjykatës Kushtetuese, kohë gjatë të cilës kërkuesi vijon të qëndrojë në kushtet e izolimit në pritje të ekstradimit të tij.

Tiranë, më 30.10.2024, ora 17:15

A N Ë T A R E

/Sonila Bejtja/(d.v.)

A N Ë T A R E

/Fiona Papajorgji/(d.v.)

K R Y E S U E S E

/Marsida Xhaferllari/(d.v.)

A N Ë T A R

/Genti Ibrahimi/(d.v.)

A N Ë T A R

/Sandër Beci/(d.v.)

A N Ë T A R

/Ilir Toska/(d.v.)

A N Ë T A R E

/Marjana Semini/(d.v.)

Vërtetohet njësia me origjinalin

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Eugen PAPANDILE

